



Projekti: Zhvillimi i Sistemeve Policore të Besueshme dhe Funksionale dhe Rritja e Luftimit të Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe bashkëpunimi Policor

Përqëndrimi: Forcimi i kapaciteteve policore kundër krimeve serioze në Europën jug-lindore

MODULI 1/ PUNIMI 1.5: RITJA E EFIKASITETIT TË KAPACITETEVE PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E KRIMIT MIDIS VENDEVE TË EUROPËS JUG-LINDORE

Punimi 1.5	Krijimi i kapaciteteve më efikase për bashkëpunim në fushën penale midis shteteve të Europës jug-lindore
Rajoni i projektit	Europa jug-lindore: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi ¹ , “IRJM”
Buxheti i aktiviteteve 1.5	EURO 237 483
Financimi	Komisioni European, Programi CARDS – Këshilli i Europës
Implementimi	Këshilli i Europës (Departmenti i Çështjeve të Krimit/DGI – Çështjet Ligjore)
Kohëzgjatja	30 muaj (Mars 2004 – Gusht 2006)

PRAPAVIJA DHE JUSTIFIKIMI

Vendet e Europës jug-lindore kanë bërë përparim të dukshëm në vitet e fundit me miratimin e instrumenteve Europiane dhe tjera ndërkombëtare që e lehtësojnë bashkëpunimin për çështjet e krimit, dhe në veçanti për çështjet e lidhura me krimin e organizuar, korrupsionin dhe pastrimin e parave. Veç kësaj, janë nënshkruar një sërë marrëveshesh bilaterale ndërmjet vendeve.

Sidoqoftë, bashkëpunimi brenda tyre dhe poashtu ndërmjet tyre dhe shteteve anëtare të BE-së mbetet i ngadalshëm dhe i paqëndrueshëm dhe si pasojë e kësaj i pa efektshëm. Arsytet, ndër të tjera janë:

- Mungesa e besimit tek autoritetet homologe të vendeve tjera.
- Shumë shtresa janë të involvuara në lëshimin dhe ekzekutimin e dokumentacionit për vazhdimin e hetimeve.
- Nuk janë të njohura procedurat, kërkesat, detajet e autoritetit relevant të vendit, që don të thotë se informatat në dokumentacionin për vazhdimin e hetimeve nuk janë të plota, dhe kërkesat kthehen ose kurrë nuk arrijnë në destinimin e duhur.
- Kërkesat për asistencë ligjore nuk konsiderohen prioritet nga autoriteti kërkuar.

¹ Rajoni i projektit e përfshin edhe Kosovën (Serbia dhe Mali i Zi), aktualisht nën administrimin e përkohshëm të UNMIK-ut në pajtim me rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

- Kapaciteti për përkthimin e dokumenteve në gjuhët e duhura është i kufizuar. Në disa vende, institucionet përgjegjëse për asistencë të përbashkët ligjore nuk kanë burime për përkthim. Ajo që në shikim të parë mund të duket një problem i vogël teknik është në fakt një pengesë e madhe që ndërpre bashkëpunimin efikas.
- Ministritë e Drejtësisë dhe Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm garojnë për të drejtën ekskluzive të të qenit kanal i vetëm për asistencë të përbashkët ligjore. Përveç kësaj, këto institucione qendrore në disa vende kanë për qëllim të kontrollojnë autoritetet në nivelin lokal dhe regional dhe t'i pengojnë ato në angazhimin për bashkëpunimin direkt me homologët e tyre jashtë vendit.
- Edhe pse janë nënshkruar shumë marrëveshje bilaterale në mes të vendeve të rajonit, autoritetet e përfshira ose ato që kanë nevojë për bashkëpunim ndërkombëtar nuk janë domosdoshmërisht të trajnuara për aplikimin e këtyre marrëveshjeve.
- Mundësitë që përfshihen në konventën në fuqi (Neni. 15 i Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale) nuk shfrytëzohen sa duhet.
- Marrëveshjet ndërkombëtare e bilaterale, dhe rregulloret nacionale lejojnë shumë mundësi dhe mënyra direkte të asistencës së përbashkët ligjore. Në të njëjtën kohë kjo krijon një pasiguri rreth asaj se çka është e mundur dhe çka është e ligjshme. Si pasojë përdoret kanali klasik nëpërmjet të Ministrisë së Drejtësisë.
- Problemi specifik i bashkëpunimit është i lidhur me Kosovën pasi që vendet nuk kanë marrëveshje të bashkëpunimit me UNMIK-un.

Gjatë forumit BE-Ballkani Perëndimor (Nëntor 2003), është pajtuar se bashkëpunimi juridik duhet të luajë një rol të rëndësishëm në rritje sa i përket kornizës së përgjithshme të marrëdhënieve në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Në mënyrë që të tejkalohen problemet e larte përmendura, vendet e Europës jug lindore janë angazhuar në një proces të rrjetit juridik që përfshin caktimin e pikave të kontaktit, përgatitjen e një doracaku për bashkëpunim dhe takime të rregullta për adresimin e problemeve specifike lidhur me bashkëpunimin. Ky proces duhet të konsolidohet dhe zgjerohet edhe më tej.

Vendet duhe të përkrahen në veçanti për nënshkrimin e Protokolit të dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS 182) që është i hapur për nënshkrim në Nëntor 2001. Ky protokol ka për qëllim rritjen e aftësisë së Shteteve për reagim në krimin ndër-kufitar duke e zgjeruar gamën e rasteve kur asistencë e përbashkët është e nevojshme dhe duke bërë përgatitjen e asistencës më të lehtë, më të shpejtë dhe fleksibile. Ndër të tjera sigurohen, kanale më efikase komunikimi, shkëmbim spontan i informatave, seanca dëgjimi me telefon dhe video konferencë, vëzhgime ndër-kufitare, dorëzime të kontrolluara, hetime të fshehta, ekipe të përbashkëta hetuese, mbrojtje të dëshmitarëve dhe masa furnizuese.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të afronte vendet e Europës jug-lindore më afër standardeve të Bashkimit Europian, mirëpo implementimi i saj në praktikë do të përfshijë sfida të konsiderueshme. Pra, vendet e rajonit do të kenë nevojë për këshillim legjislativ dhe trajnime gjithpërfshirëse për t'i shfrytëzuar plotësisht këto mundësi.

PUNIMI 1.5 QËLLIMI, AKTIVITETET DHE REZULTATET E PRITURA

Qëllimi specifik i Punimit 1.5 është që ta forcojë kapacitetin për bashkëpunim në çështjet penale në mes të vendeve të Europës jug-lindore, në veçanti duke i përkrahur përpjekjet e disa Shteteve Anëtare për të ratifikuar dhe implementuar protokolin e dytë shtesë të Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS 182) nëpërmjet:

- zhvillimit të strategjive për ratifikimin dhe implementimin e ETS 182
- zhvillimit dhe testimit të materialeve trajnuese në fushën e bashkëpunimit për çështjet e krimit

Aktivitetet e Punimit 1.5 duhet të vështrohen në kornizën globale të Modullit 1, i cili ka për qëllim zhvillimin e strategjisë regjionale kundër krimit ekonomik dhe atij të organizuar në Europën jug-lindore bazuar në përvetësimet nga Bashkimi Europian dhe praktikatat e standardet Europiane, si dhe në furnizimin e institucioneve për zbatimin e ligjit me mjetet e nevojshme për implementimin e strategjisë.

Rezultatet e tij do të përbëjnë një pjesë të tërësishme që do të sëndërtohet në aktivitetet e lidhura me zhvillimin e strategjisë rajonale kundër krimit ekonomik dhe atij të organizuar në Europën jug-lindore bazuar në përvetësimet nga Bashkimi European dhe praktikatat e standardet Europiane

AKTIVITETI 1.5.1 ZHVILLIMI I STRATEGJISË PËR RATIFIKIMIN DHE IMPLEMENTIMIN REAL TË PROTOKOLIT TË DYTË SHITESË TË KONVENTËS EUROPIANE PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË NË FUSHËN PENALE (ETS 182)

		Datat
1.5.1.1	Seminari regjional për mundësitë e ofruara nga Protokoli i dytë Shtesë i Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS 182)	2-3 Shtator 2004
1.5.1.2	Asistenca afat-shkurtër e ekspertëve për shqyrtimin e hapësirave të pambuluara dhe mundësive në legjislacion dhe kapaciteteve institucionale	Shtator – Tetor 2004 (in house)
1.5.1.3	Seminari regjional për elaborimin e planeve implementuese për secilin vend	22-23 Nëntor 2004
1.5.1.4	Përkrahje nga ekspertët për krijimin e draftit të amandamenteve legjislative	Shkurt – Tetor 2005

AKTIVITETI 1.5.2 ZHVILLIMI, TESTIMI DHE VËNIA NË DISPOZICION E MATERIALIT TRAJNUES PËR TRAJNIMET E MËTUTJESHME

		Datat
1.5.2.1	Seminar regjional për shqyrtimin e nevojave të trajnimit	12-13 Prill 2005
1.5.2.2	Asistenca afat-shkurtër e ekspertëve për zhvillimin e materialit të trajnimit dhe udhëzimeve për bashkëpunim ndërkombëtar	Maj – Shtator 2005
1.5.2.3	Mbledhje pune(vorkshop) regjionale për finalizimin e koncepteve dhe materialeve për trajnim	Shtator 2005
1.5.2.4	Trajnime lokale nga trajnerë vendorë bashkë me përkrahje nga ekspertë për përmirësimin e mëtutjeshëm të materialit për trajnim	Shtator 2005 – Prill 2006
1.5.2.5	Prodhi i materialit për trajnim në gjuhët lokale	Prill- Gusht 2006

Në fund të projektit:

- do të duhej elaboruar strategjia për ratifikimin dhe implementimin e ETS 182 ,
- do të duhej përfunduar analiza gjithëpërfshirëse e secilit rajon të projektit për legjislacionit aktual, dhe për kapacitetet institucionale dhe hapësirat e pambuluara si dhe rekomandimet për zhvillimet e mëtutjeshme të legjislacionit dhe kapacitetit ndërtues institucional,
- do të duhej siguruar përkrahje nga ekspertët për krijimin e draftit të legjislacionit implementues në lidhje me ETS 182,
- do të duheshin identifikuar nevojat për trajnim në këtë rajon dhe në përputhje me këtë do të zhvilloheshin dhe testoheshin materialet për trajnim,
- do të duhej mbajtur një seri trajnimesh për secilin rajon të projektit.

PJESËMARRËSIT

Një numër i përfaqësuesve relevant të autoriteteve qendrore nga secili rajon projektit, si dhe autoritetet gjyqësore dhe ato për zbatimin e ligjit (ekzekutive) që janë përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkombëtar për çështjet e krimit dhe institucionet trajnuese.

Ekspertët nga Shtetet anëtare të Këshillit të Europës më njohuri të gjerë në fushëm e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e krimit, në veçanti ata me përvojë konkrete për implementimin e ETS 182 në vendet e tyre, praktikantë me përvojë relevante pune në fushat e përfshira nga ETS 182 (seanca degjimore me telefon dhe video konferencë,

mbikëqyrje ndër-kufitare, dorëzime të kontrolluara, hetime sekrete, ekipe të përbashkëta hetuese, mbrojtje e dëshmitarëve etj) dhe trajnuesit.

PËR ÇFARËDO INFORMATE SHITESË JU LUTEMI KONTAKTONI:

Departamenti i Problemeve të Krimin, Seksioni i bashkëpunimit Teknik, Drejtorati i Përgjithshëm – Çështjet Ligjore, Këshilli i Europës, 67075 Strazburg CEDEX, Francë



+ 33-3-9021-4260, Faksi + 33-3-8841-2052, ✉: livia.stoica@coe.int

ANEKSI. I : PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE

(1) Aktiviteti 1.5.1: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.1.1 – Seminari regjional për mundësitë e ofruara nga Protokoli i 2-të Shtesë i Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale (ETS 182)

AKTIVITETI	Seminari regjional për mundësitë e ofruara nga Protokoli i 2-të Shtese i Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale (ETS 182)
LOKACIONI	Prishtinë, Kosovë (Serbi dhe Mali i Zi)
KOHËZGJATJA / DATA	2-3 Shtator 2004
GJUHA/GJUHËT E PUNËS	Anglisht. Do të sigurohet përkthimi në gjuhët vendore
QËLLIMET SPECIFIKE	- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve relevante për të shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga ETS 182, rrjedhimisht duke përmirësuar kapacitetet e tyre për të reaguar në mënyrë adekuate ndaj krimit ndër-kufitar - Forcimi i rrjetit dhe shkëmbimit të përvojave lidhur me implementimin e këtij protokoli në mes zyrtarëve të secilit rajon të projektit që janë përgjegjës për bashkëpunim ndërkombëtar.
PËRMBAJTJA	Për ekspertët relevantë ky seminar do të krijojë mundësinë e ekzaminimit të tërësishëm të shumëllojshmërisë së mjeteve nën ETS 182 për qëllim të përparimit të bashkëpunimit në lidhje me çështjet e krimit. Si shtesë, ekspertët nacionalë do të diskutojnë çështjet në korniza për implementimn e ETS 182 si dhe aspektet që duhen përfillur në procesin e shqyrtimit të legjislacionit të tyre dhe kapaciteteve institucionale.
PJESËMARRËSIT	5-8 përfaqësues nga secili rajon i projektit nga autoritetet qendrore, autoritetet gjyqësore dhe ato për zbatimin e ligjit e që janë përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet e krimit (nga departmentet relevante të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, Policisë, Zyrës Supreme të Kasacionit, zyrës kombëtare të Interpolit, etj)
EKSPERTËT	Ekspertët nga Shtetet anëtare të Këshillit të Europës me njohuri të gjerë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e krimit, në veçanti ata me përvojë konkrete për implementimin e ETS 182 në vendet e tyre. Praktikantë me përvojë relevante pune në fushat e përfshira nga ETS 182 (seanca shqyrtimi me telefon dhe video konferencë, vëzhgime ndër-kufitare, dërgime të kontrolluara, hetime të fshehta, ekipe të përbashkëta hetuese, mbrojtje e dëshmitarëve etj).
REZULTATET E PRITURA	- Ekspertët nacionalë do t'i shtojnë njohuritë e tyre në lidhje me Konventën Europiane mbi Asistencën e Përbashkët për çështjet e krimit dhe protokolin e dytë të saj - Ekspertët nacionalë do të pajtohen për përdorimin e një matrice gjithëpërfshirëse dhe një pyetësori që do të përdoret në seancën e shqyrtimit në lidhje me hapësirat e pambuluara dhe mundësive në legjislacion dhe kapaciteteve institucionale. Ekspertët nacionalë do ta miratojnë dhe më tutje ta kompletojnë planin e punës si dhe përshkrimin e aktiviteteve që do të ndërmerren nën Aktivitetin 1.5.1

(2) Aktiviteti 1.5.1: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.1.2 – Shqyrtimi i hapësirave të pambuluara dhe mundësive në legjislacion dhe kapaciteteve institucionale.

LLOJI I AKTIVITETIT	Analiza
TEMA	Shqyrtimi i hapësirave të pambuluara dhe mundësive në legjislacion dhe kapaciteteve institucionale për implementimin efektiv të Protokolit të 2-të Shtesë të Konventës Europiane mbi Asistencën e Përbashkët Ligjore për Çështjet e Krimit (ETS 182)
LOKACIONI	I brendshëm
KOHËZGJATJA / DATA	Shtator – Tetor 2004
GJUHA E PUNËS	Anglisht
QËLLIMI	Të ndërmirret një shqyrtim i tërësishëm i kapaciteteve institucionale dhe legjislacionit aktual në secilin rajon të projektit, gjithashtu të shqyrtohen hapësirat e pambuluara dhe mundësitë e disponueshme që mundësojnë implementimin efektiv të ETS 182 në secilin vend.
PËRMBAJTJA	Do të bëhet shqyrtimi në përputhje me matricën gjithëpërfshirëse të zhvilluar gjatë seminarit të parë regjional. Do të dërgohen pyetësorë tek zyrtarët relevantë të secilit rajon për t'i plotësuar. Do të dërgohen në Shtator 2004 dhe do të caktohet afati përfundimtar për plotësimin e tyre. Shqyrtimi do të bëhet në bazë të informatave të siguruar nga pyetësori dhe nga secili rajon i projektit, dhe në përputhje me këtë do të përfundohet matrica e shqyrtimit. Kjo do të përfshijë një listë të rekomandimeve konkrete për zhvillimin e mëtutjeshëm të legjislacionit dhe kapaciteteve ndërtuese institucionale me qëllim të implementimit të ETS 182.
REZULTATET E PRITURA	Deri në fund të Shtatorit, do të përfundohet një analizë gjithëpërfshirëse për çdo rajon të projektit dhe do ti vëhet në dispozicion për komente institucioneve relevante nga secili rajon projektit.
EKSPERTIZA / EKSPERTËT E NEVOJSHËM	2-3 ekspertë për afat të shkurtër me njohuri të gjerë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e krimit, në veçanti me njohuri konkrete për implementimin e ETS 182 në vendet e tyre që do të ngarkoheshin për elaborimin e analizave të lart përmendura. Gjatë procesit nevojiten informacione nga autoritetet qendrore, autoritetet gjyqësore dhe ato për zbatimin e ligjit, që janë përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar.
PJESËMARRËSIT	Profili: përfaqësues nga autoritetet qendrore, autoritetet gjyqësore dhe ato për zbatimin e ligjit, që janë përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar Gjithsejt: Aq sa është relevante.
KONKLUZIONET/ PASUESE²	
TË TJERA	Shënim: Implementimi efektiv i këtij aktiviteti kërkon bashkëpunimin e plotë në mes të zyrtarëve nga secili rajon i projektit dhe ekspertëve të caktuar për afat të shkurtër në mënyrë që të sigurohen informacionet e duhura sipas marrëveshjes kalendarike për përfundimin e pyetësorit, dhe sipas nevojës, mundësia e sigurimit të informatave dhe qartësimeve shtesë nga ana e tyre.

² Do të plotësohet pas përfundimit të aktivitetit

(3) Aktiviteti 1.5.1: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.1.3 – Seminar regional për elaborimin e planeve implementuese për secilin vend

LLOJI I AKTIVITETIT	Seminar regional
TEMA	Elaborimi i planit implementues për secilin vend për të përkrahur implementimin e Protokolit të 2-të Shtese të Konventës Europiane mbi Asistencën e Përbashkët Ligjore për Çështjet e Krimit (ETS 182)
LOKACIONI	Serbi (Serbi dhe Mali i Zi)
KOHËZGJATJA / DATA	2 ditë / 22 - 23 Nëntor 2004
GJUHA E PUNËS	Anglisht. Do të sigurohet përkthimi në gjuhët vendore
QËLLIMI	Ky seminar ka për qëllim sigurimin e përkrahjes nga ekspertët për zhvillimin e planeve implementuese për secilin vend për t'iu bërë atyre të mundur shfrytëzimin e plotë të Protokolit të 2-të Shtesë të Konventës Europiane mbi Asistencën e Përbashkët Ligjore për Çështjet e Krimit (ETS 182)
PËRMBAJTJA	Ekspertët nacionalë dhe ekspertët për afat të shkurtër do të diskutojnë konkluzionet dhe rekomandimet e këtij shqyrtimi në sferën e obligimeve që derivojnë nga ky instrument ndërkombëtar, si dhe do të diskutojnë komentet e dhëna për secilën analizë. Ata do të dakordohen për përbërësit e rëndomtë të plan veprimit për implementimin e ETS 182 dhe më tutje do të udhëzojnë në lidhje me masat specifike të vendit që e garantojnë implementimin e tij. Në fund pjesëmarrësit do të diskutojnë rekomandimet për zhvillimin e mëtutjeshëm të legjislacionit dhe kapacitetit ndërtues institucional, si dhe të pajtohen për një plan pune për përkrahjen e aktiviteteve gjatë procesit për krijimin e draftit të legjislacionit relevant që duhet implementuar nga Shkurti deri në Tetor 2005.
REZULTATET E PRITURA	Do të hartohet në vija të trasha një “model” gjithëpërfshirës i plan veprimit për implementimin e Protokolit të 2-të Shtesë të Konventës Europiane mbi Asistencën e Përbashkët Ligjore për Çështjet e Krimit (ETS 182) nga ana e ekspertëve nacionalë, ku do të përfshihen masat me veprim të orientuar që janë specifike për vendin. Do të duhej përfunduar një kalendar me data të caktuara për përkrahjen a aktiviteteve që lidhen me krijimin e draftit të legjislacionit relevant për periudhën nga Shkurti deri në Tetor 2005
EKSPERTIZA / EKSPERTËT E NEVOJSHËM	2-3 ekspertë për afat të shkurtër me njohuri të gjerë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e krimit, në veçanti me njohuri konkrete për implementimin e ETS 182 në vendet e tyre.
PJESËMARRËSIT	Profili: përfaqësues nga autoritetet qendrore, autoritetet gjyqësore dhe ato për zbatimin e ligjit, që janë përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar Gjithsejt: deri në 50 pjesëmarrës (delegacionet me nga 6 persona prej secilit rajon të projektit)
KONKLuzionET/ PASUESE³	

³ Do të plotësohet pas përfundimit të aktivitetit

(4) Aktiviteti 1.5.1: Përshkrimi i nën aktivitetit 1.5.1.4 – Mbledhje pune për krijimin e draftit të amandamenteve legjislative

LLOJI I AKTIVITETIT	Mbledhje pune teknike
TEMA	Mbledhje pune për krijimin e draftit të implementimit legjislativ në lidhje me Protokolin e 2-të Shtesë të Konventës Europiane mbi Asistencën e Përbashkët Ligjore për Çështjet e Krimit (ETS 182))
LOKACIONI	Secili rajon i projektit (sipas kërkesës)
KOHËZGJATJA / DATA	1 deri në 1,5 ditë / Shkurt - Tetor 2004 Do të arrihet marrëveshje për datat e sakta të mbledhjeve nacionale të punës gjatë seminarit regjional të kaluar (nën-aktiviteti 1.5.1.3)
GJUHA E PUNËS	Anglisht/ Përkthimi do të mund të sigurohet në varësi prej fondeve të disponueshme dhe në bazë të shpërndarjes së barrës financiare.
QËLLIMI	Mbledhja e punës ka për qëllim sigurimin e përkrahjes teknike gjatë procesit të elaborimit të legjislacionit relevant për implementim.
PËRMBAJTJA	Përmbajtja e secilës mbledhje të punës do të definohet në pajtim me nevojat specifike për përkrahje teknike për secilin rajon të projektit dhe në pajtim me planet implementuese të elaboruara sipas specifikave të vendit.
REZULTATET E PRITURA	Secilit vend do ti sigurohej përkrahja konkrete teknike gjatë krijimit të draftit të legjislacionit implementues relevant dhe legjislacionit bazë dhe / ose amandamentet legjislative do të jenë në dispozicion për adoptim në secilin rajon të projektit.
EKSPERTIZA / EKSPERTËT E NEVOJSHËM	2-3 ekspertë për afat të shkurtër me njohuri të gjerë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e krimit, në veçanti me njohuri konkrete për implementimin e ETS 182 në vendet e tyre.
PJESËMARRËSIT	Profili: anëtarët e grupeve punuese nacionale që janë përgjegjës për krijimin e draftit të legjislacionit relevant për implementim. Gjithsejt: Aq sa është relevante
KONKLUZIONET/ PASUESE⁴	
TË TJERA	Një nevojë preliminare për garantimin e efektivitetit të këtyre aktiviteteve është që para organizimit të tyre në secilin rajon të projektit grupet punuese nacionale duhet të përgatitin dhe vënë në dispozicion për ekspertët afat-shkurtër një draft, i cili do të përbëjë bazën kryesore për diskutimin dhe për ushtrimin e draftit.

⁴ Do të plotësohet pas përfundimit të aktivitetit

- (5) Aktiviteti 1.5.2: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.2.1 – Seminar regjional për shqyrtimin e nevojave për trajnim mbi bashkëpunimin ndërkombëtar**

Shënim: Të përfundohet përpara lansimit të kësaj faze të projektit në 2005.

- (6) Aktiviteti 1.5.2: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.2.2 – Zhvillimi i materialeve për trajnim dhe direktivave për bashkëpunim ndërkombëtar**

Shënim: Të përfundohet përpara lansimit të kësaj faze të projektit në 2005.

- (7) Aktiviteti 1.5.2: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.2.3 - Mbledhje pune regjionale për finalizimin e koncepteve dhe materialeve trajnuese**

Shënim: Të përfundohet përpara lansimit të kësaj faze të projektit në 2005.

- (8) Aktiviteti 1.5.2: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.2.4 – Trajnime lokale për testimin dhe përmirësimin e mëtutjeshëm të materialve trajnuese të mbajtura nga trajnerët vendorë me përkrahje nga ekspertët**

Shënim: Të përfundohet përpara lansimit të kësaj faze të projektit në 2005.

- (9) Aktiviteti 1.5.2: Përshkrimi i nën-aktivitetit 1.5.2.5 – Prodhimi i materialeve trajnuese në gjuhët vendore**

Shënim: Të përfundohet përpara lansimit të kësaj faze të projektit në 2005.